

# NEWSLETTER

## Universiteti Bujqësor i Tiranës

### Kërkimet shkencore në fushën e Antimikrobiko Rezistencës-fushë e rëndësishme e kërkimit shkencor në UBT

Si një ndër problemet më madhore e serioze, që përfaqëson ndoshta krizën më të madhe globale sot në shëndetin publik në botë, e ngjashme me ndryshimin e klimës, rezistenca antimikrobike (AMR) është bërë një ndër fushat kryesore kërkimore të stafit të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Në këtë kuadër, një ekip studiuesish nga Boston University, USA, konkretisht Dr. Indorica Sutradhar, Dr. Darash Desai dhe Neila Gross, zhvilluan një leksion të hapur me temë: Antimicrobial Resistance-Research and Inovation.



### MË TË LEXUAR:

#### WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/BLOG/UNIVERSITETI-13/MUNDESI-PRAKTIKE-PER-GJENDJEN-NE-RAJONIN-ADRIATIK-JONIAN-360](https://www.ubt.edu.al/blog/universiteti-13/mundesipraktike-per-gjendjen-ne-rajonin-adriatik-jonian-360)

#### UBREEN

[HTTPS://UBGREEN.AL/CFARE-SHKAKTON-MUNGESA-E-ZINKUT-NE-ORGANIZEM/](https://ubgreen.al/cfare-shkakton-mungesa-e-zinkut-ne-organizem/)

### Follow us:



UNIVERSITETIN  
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI\_BUJQËSOR  
\_TIRANES





## UBT në panairin “Ditët e Informimit të Maturantëve”

### UBT partner në projektin me titull “Platform for helping small and medium farmers to incorporate digital Technology for Improved Opportunities PHITO”

Për herë të parë UBT është pjesëmarrës në një projekt serioz të financuar nga HORIZON-IA për periudhën 2023-2028.

Ky projekt prezanton një teknologji dixhitale novatore posaçërisht për fermerët e vegjël dhe të mesëm (SMF) që aktualisht nuk janë në gjendje të përfitojnë nga inovacioni dixhital i adoptuar gjithnjë e më shumë nga prodhuesit më të mëdhenj.



### Fakulteti i Shkencave Pyjore feston 60-vjetorin e “Ditës së Inxhinierit të Pyjeve”

Në kuadër të kësaj dite të shenjuar, Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Pyjore, Prof. Dr. Leonidha Peri pritën në një takim Znj. Anisa Ruseti, Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit - Bashkia Tiranë dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Z. Artur Kala.

Pjesëmarrësit në këtë takim diskutuan mbi gjendjen aktuale dhe sfidat e sotme e të së ardhmes për profesionin e inxhinierit të pyjeve, duke prekur dhe mundësitë e tregut të punës nga sektori shtetëror dhe privat për specialistët e rinj.



**Universiteti Bujqësor i Tiranës firmos marrëveshje Bashkëpunimi me kompanitë BroTech Brands dhe F&M Reklama me qëllim ofrimin e praktikave mësimore dhe punësimit të studentëve.**

Për të firmosur marrëveshjet Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku priti në një takim Administratorin e kompanisë F&M Reklama, Z. Faolt Pahija.

Palët angazhohen në realizimin e projekteve apo aktiviteteve të përbashkëta për praktika profesionale të studentëve, kërkimin shkencor, transferimin e njohurive, të teknologjisë, trajnimeve apo shërbimeve të tjera.



# NEWSLETTER



## Universiteti Bujqësor i Tiranës

### Përfundon rindërtimi i godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë së Ushqimit dhe Klinikës Veterinare

Universiteti Bujqësor përfundon rindërtimi i godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë së Ushqimit dhe Klinikës Veterinare, investime që kanë krijuar kushtet më të mira për 2,400 studentë dhe mbi 140 pedagogë të UBT.

Fokusi kryesor është ndërkombëtarizimi, përmes programeve të përbashkëta me universitete prestigjioze në Europë, siç është Universiteti Boku i Vjenës, me të cilin po formalizohet bashkëpunimi me UBT, për të përmirësuar standardet e arsimit në Shqipëri.



### MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/BLOG/ERASMUS-3/THIRRJE-CORDOVA-2024-348](https://www.ubt.edu.al/blog/erasmus-3/thirrje-cordova-2024-348)

UBREEN

SI MUND T'I PËRGJIGJET BUJQËSIA QELIZORE KËRKESAVE GLOBALE NË RRITJE PËR USHQIM?

### Follow us:



UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI\_BUJQËSOR\_TIRANES





## 101 VJETORI I SHËRBIMIT PYJOR

### Ambasadorja e Francës në Shqipëri viziton për herë të parë Universitetin Bujqësor të Tiranës

Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku priti në një takim Ambasadoren e Francës në Shqipëri, SH. S. Znj. Catherine Suard dhe stafin e saj, Z. Pierre Raynaud (Këshilltar për Bashkëpunimin dhe Kulturën) dhe Z. Alexandre Martinez (Këshilltar Rajonal për Çështjet e Bujqësisë dhe Ushqimit).



### UBT nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi me Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural

Marrëveshja e firmosur nga Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Znj. Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare e ANRD ka për qëllim bashkëpunimin e qëndrueshëm mes dy palëve në fusha me interes të përbashkët të tilla si: edukimi dhe trajnimi profesional, kërkimi shkencor, dialogu për politikën e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm bujqësor e rural.

### Fondacioni Federal Gjerman për Mjedisin (DBU) mbajti një sesion informues para studentëve dhe pedagogëve të UBT

Z. Alexander Bittner, Përgjegjës në DBU për Programin CEE për Ballkanin Perëndimor dhe Znj. Claudia Domel, Përgjegjëse për Projektet Ndërkombëtare për Europën Qendrore dhe Lindore ofruan një informacion të detajuar mbi mundësitë që ofron DBU për studentët dhe stafin akademik të UBT.

Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku teksa mirëpriti delegacionin përfaqësues nga DBU, i njohu ata edhe me një pasqyrë të përgjithshme të UBT dhe të prespektivave të tij për të ardhmen në funksion të zhvillimit të edukimit, kërkimit shkencor dhe transferimit të njohurive.

